



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:165259  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05527723

**P.nr.124/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.F., për shkak të veprave penale: I. Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), dhe II. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2595/2018 (2019:0066951) të datës 28.10.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 27.02.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të pandehurit B.F. si dhe mbrojtësja e tij sipas autorizimit, avokate Fatmire Braha, me datë 29.02.2024, e shpalli publikisht, ndërsa me datën 29.03.2024, e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

B.F., nga i ati M., e ëma Z., e vajzërisë S., i lindur me datë ... në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në Rr. "...", me numër personal ..., ka të kryer fakultetin Ekonomik, drejtor i firmës "...", i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

**I**

Me datë 27.09.2017 në shtëpinë e tij në rrugën e "U...", në Mitrovicë në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm mbi armët ka poseduar pistoletën Pietro Berta Gardone, prodhim italian, me nr. serik ....., kalibrit 7.65 mm, me një karikator me pesë fishekë, e cila i është sekuestruar nga policia.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.**

**II**

Me datë 27.09.2017, rreth orës 17:25 minuta, në rrugën e "U...." në Mitrovicë në afërsi të firmës "...", për shkak të një mosmarrëveshjeje rreth kycjes së rrymës në rrjetin e firmës "...", e në

kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm mbi armët ka përdorur në mënyrë kërcënuese pistoletën Pietro Bereta Gardone, ndaj të dëmtuarit B.H., duke ia drejtuar në gjoks dhe kanosur me fjalët: “askush nuk guxon ta kyçë rrymën”.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, 80 e lidhur me nenin 374 dhe 375 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, i:

### CAKTON

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, i cakton dënim me gjobë në shumë prej 800.00 (me fjalë: tetëqind) euro.

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 1,000.00 (me fjalë: njëmijë) euro.

Gjykata, në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, të pandehurit B.F., i:

### SHQIPTON

- I. DËNIM UNIK me gjobë në shumë prej 1,800.00 euro (me fjalë: njëmijë e tetëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t’ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve, i cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej dy (2) vitesh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Në mbështetje të nenit 374 par.3 dhe 375 par.3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 të KPP-se, të pandehurit i konfiskohen sendet dhe atë:
  - Pistoleta Pietro Berta Gardone, prodhim italian, në nr. serik ..... kalibrit 7.65 mm,
  - një karikator me pesë (5) fishekë.

Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, armët të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pasi të vërtetohet se armët nuk janë përdorur në ndonjë rast tjetër penal nga Libri i Rasteve të Hapura.

- III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV.** Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

### **A r s y e t i m**

#### *Rrjedha e procedurës:*

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2595/2018 të datës 28.10.2021, kundër të pandehurit B.F., për shkak të veprave penale: I. Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe II. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht rikujton se për këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor me datën 20.09.2022, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në të cilën i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës II të aktakuzës dhe gjykata ka vazhduar me shqyrtim gjyqësor kryesor vetëm për pikën II të aktakuzës dhe në raport për pikën I, gjykata kishte vendosur se aktgjykimin do ta shpallte kur të përfundonte çështja penale dhe do të vendoste me një vendim të vetëm.

Me akt përcjellësin e datës 23.02.2024, nga zyra e menaxhimit të lëndëve është bartur lënda në Departamentin e Përgjithshëm dhe është vazhduar shqyrtimi gjyqësor ndaj të pandehurit B.F. për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 30.11.2023, 20.02.2024 dhe 27.02.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri B.F., mbrojtësja e tij sipas autorizimit, avokate Fatmire Braha. Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihej në barrë (pra për veprën penale sipas pikës II të aktakuzës), ndërsa gjykata ka dëgjuar dëshmitarët, L.S. dhe A.B., ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

#### *Fjala përfundimtare e palëve:*

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se, pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veç e veç dhe të gjitha së bashku është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari B.F. ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së. Tutje, ka theksuar se sa i përket veprës penale si në pikën I të aktakuzës, i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.09.2022. Se i akuzuari e ka kryer veprën penale si në pikën II të aktakuzës

është vërtetuar nga provat të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe atë nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit B.H. dhe e dëshmitarëve L.S., A.B. dhe B.T.. Nga të gjitha këto vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale, pasi që nuk është kontestuese se arma është e tij, për të cilën e ka pranuar fajësinë, po ashtu se të njëjtën e ka fshehur afër pishës në oborrin e firmës “B.”, po ashtu vërtetohet se i njëjti ia ka drejtuar armën në gjoks të dëmtuarit B.H. dhe duke iu drejtuar me fjalët “*se askush nuk guxon të kyç rrymën*”. Më tej ka shtuar se lidhur më dëshmitë e dëshmitareve është filluar procedura ndaj tyre për veprën penale Deklarimet e rreme nga neni 384 i KPRK-së, të njëjtit kanë ndikuar nga ndërhyrja e padrejtë duke tentuar që përgjegjësinë t’i lënë prindit të të akuzuarit i cili ka ndërruar jetë. Po ashtu edhe nga deklaratat e të akuzuarit i njëjti ka deklaruar se armën e ka mbajtur për çështje sigurie por që e ka mohuar faktin që e ka përdorur në mënyrë kërcënuese, duke shtuar se të njëjtën e kishte lënë në një pishë para se të shkoj tek trafo, e që ky deklarim është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve , prandaj ka kërkuar nga gjykata që mos t’ia falë besimin kësaj deklaratë e cila është në kundërtënie të plotë me dëshmitë të dëshmitarëve. Gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe të njëjtit të shqiptoj një sanksion penal më të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese të merr parasysh dashjen e lartë në kryerjen e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore që paraqesin kjo natyrë e veprave penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale ku i akuzuari e ka mbajtur në posedim dhe e ka përdorur në mënyrë kërcënuese armën, dhe nga të gjitha këto kërkojmë që në këtë çështje penale të merret aktgjykim konform nenit 364 të KPP-së.

Mbrojtësja e të pandehurit B.F., avokate Fatmire Braha, fjalën përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim në format A4, gjithsej katër faqe dhe të njëjtën e ka elaboruar, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se i mbrojturi i saj në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.09.2022 e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa nuk e ka pranuar për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së. Tutje, ka theksuar se i dëmtuari- dëshmitari B.H. në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.09.2022, ka deklaruar se personi i cili ia ka drejtuar alltinë ka qenë një person i moçëm dhe nuk është i pandehuri, dhe nuk e ka mohuar deklaratën e dhënë në polici, por vetëm ka mohuar se ka qenë ky person. Ndërsa dëshmitari L.S. në shqyrtimin gjyqësor të datës 30.11.2023, ka deklaruar se nuk e ka ditur se kush ka qenë pronar i firmës “T. B.”, ka menduar se personi me flokë të bardha ka qenë B. dhe për mua (për dëshmitarin) në atë kohë ka qenë B. ai plaku, dhe personi prezent i akuzuari nuk ka qenë ai person i cili ka repetu armë dhe të njëjtit nuk i ka parë armë. Për dëshmitarin A.B. në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 30.11.2023, ka deklaruar se personalisht nuk ka parë armë, por vetëm është folur se pronari i firmës M.F. ka pasur armë. Gjithashtu dëshmitari B.T. nuk përmendet askund në arsyetimin e aktakuzës nëse ka dhënë dëshmi apo jo, e cila nuk është dorëzuar as neve si mbrojtje, i ka propozuar gjykatës të mos ia falë besimin kësaj deklaratë pasi që ka pengesa ligjore me të cilat pengesa të kujdeset edhe Gjykata sipas detyrës zyrtare. Po ashtu i mbrojturi i saj që nga fillimi i procedurës ka qenë shumë bashkëpunues dhe ka deklaruar në përpikëri se si ka ndodhur rasti, dhe veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës e ka pranuar fajësinë ndërsa për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës nuk e ka pranuar sepse nuk ka

përdorur armë ndaj të dëmtuarit dhe as nuk ka poseduar në vendin e ngjarjes të cilat rrethana janë sqaruar nga i dëmtuari dhe dëshmitarët gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj nga provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk ka mundur të vërtetohet me asnjë provë të vetme si i mbrojturi e ka kryer veprën penale si në dispozitivin e II të Aktakuzës. I mbrojturi im është familjar, drejtor i firmës “B.” dhe ka të punësuar qindra punëtorë dhe vërtetohet fakti se i njëjti nuk është i prirë për kryerjen e veprave penale por është i dobishëm për shoqërinë dhe mban biznes me të cilin krijon të ardhura për familjen edhe për veti, andaj bazuar në provat e administruara i ka propozuar Gjykatës konfrom nenit 363 par.1 nën par.1.1 dhe 1.3 të KPRK-së, që të bie aktgjykim lirues pasi që nuk është provuar se i pandehuri B.F. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet fjalën e mbrojtëses, nuk ka tjetër se çfarë të shtoj, vetëm se e ndjenë veten të pafajshëm për veprën penale të dytë përdorimi i armës.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 30.11.2023, 20.02.2024 dhe 27.02.2024 gjykata ka dëgjuar dëshmitarët B.H., L.S. dhe A.B., ndërsa ka lexuar edhe deklaratën e dëshmitarit B.T. dhënë në polici me datë 27.09.2017.

Dëshmitari B.H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.09.2022, mes të tjerash ka deklaruar se ka qenë duke punuar në firmën “B.”, punëtorët e firmës “T.B.”, e kanë ndalur rrymën, trafoja ka qenë me rrymë, e ka hequr drynin dhe e ka lëshuar rrymën, pastaj ka ardhur një person me allti, në atë kohë nuk e kam njohur se kush ka qenë ai person sepse ka pasur shumë pak kohë që kishte filluar të punonte. Tutje ka theksuar se me një person janë “rrokë”, i njëjti e ka nxjerrë alltinë, ia ka drejtuar alltinë dhe këto kanë qenë fjalët “*nuk guxon me leshu rrymën*”, është rrokë prapë me të, aty ka pasur edhe punëtor të tjerë, të cilët kanë qenë afër rreth 1 metër, i njëjti është drejtuar me fjalë kërcënuese, kur e ka drejtuar armën atëherë kanë ndërhyrë edhe punëtorët e tjerë dhe i kanë ndarë dhe ka ardhur policia. Me atë person, janë kapur për teshave dhe janë shtyrë, nuk ka pasur goditje, për trafo mendon se kanë pasur të drejtë për tu kyçur, nuk e din nëse KEDS-i a ka intervenuar apo jo, por që ka ardhur policia dhe të gjithëve i kanë marrë. Personi i cili e ka drejtuar armën ka qenë i moçëm rreth 50 vite, të cilin siç ka thënë dëshmitari, nuk e ka njohur, personi i cili është i akuzuar nuk ka qenë ai person, as nuk e di se kush ka qenë pronari, vetëm kur ka shkuar në polici e ka kuptuar dhe personi që ka qenë i moçëm ka qenë pronari i betonjerkës “B.” dhe nuk ka qenë personi i cili është i akuzuar.

Dëshmitari L.S., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 30.11.2023, ka deklaruar se, ka punuar në firmën M. në Fushë Kosovë, e cila ka pasur shumë sektorë e cila është marrë me ndërtimtari, prodhim, betoni etj. dhe kanë montuar një betonjerkë afër firmës “T.B.”, në Mitrovicë, dhe e kanë lëshuar betonjerkën e cila ka qenë në testim, në një rast është ndaluar rryma gjatë testimit të betonjerkës, dëshmitari ka qenë në silosat lartë dhe B.H. ka shkuar për të parë trafon se pse është ndaluar rryma, ka pasur shumë zhurmë, tollovi dhe ka shkuar poshtë dhe te trafo kishin qenë punëtorët e T.B disa prej punëtorëve i ka dëgjuar duke thënë “*jo bon me lshu, jo sbon me lshu*”, duke u afruar e ka parë një të moshuar me flokë të bardha që e ka nxjerrë alltinë dhe ka thënë nuk bënë me prekë ndërsa nuk e ka repetu armën. Dëshmitari ka theksuar se

personi që ka qenë me flokë të bardha, ka menduar që ka qenë B. sepse nuk i ka njohur, ndërsa M. nuk e di kush ka qenë.

Dëshmitari A.B., në shqyrtimin gjyqësor me datë 30.11.2023, ka deklaruar se ka qenë në objektin BT Petrol në Shupkovec, me kompaninë B. janë ngjitur-afër, ka qenë brenda në objektin e tyre, i ka dëgjuar disa zëra, ka dalë jashtë objekti dhe i ka parë punëtorët e kompanisë së tij dhe kompanisë B., kanë qenë diku rreth 15-20 persona, kur ka mbërri te vendi i ngjarjes të trafoja edhe kanë ardhur policia dhe sipas informatave, mosmarrëveshja ka ardhur për kyçje në trafo, dhe pasi që është interesuar se çfarë ka qenë problemi, ka dëgjuar se pronari i firmës “B.”, M.F., nuk i ka lënë të kyçen në trafo, për të cilin është folur që ka pasur armë mirëpo nuk e ka parë personalisht. Dëshmitari ka theksuar se punëtorët kanë thënë se B. ka pasur armë mirëpo kanë ngatërruar M. me B.n, për të cilën i ka treguar punëtori i firmës së tyre.

Meqenëse dëshmitari B.T., gjendet jashtë vendit dhe nuk kishte një adresë të saktë të tij, gjykata, bazuar në nenin 335 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, ka lexuar deklaratën e dhënë në Njësinë e Hetimeve në Mitrovicë, me nr. 2017-BC-970, të datës 27.09.2017, i cili ndër të tjera kishte deklaruar se me datë 27.09.2017, ai së bashku me kolegë kishin qenë te betonjerka “O.K.” dhe pas tre orësh, dikush nga firma “B. e kishte çkyqur rrymën dhe e kishin lajmëruar KEDS-in, të cilët kanë dërguar një ekip për të kyçur trafon, pasi që erdhën të njëjtët u konsultuan me firmën “B.”, the i lajmëruan se nuk mund ta kyçin rrymën me një fjalë “*të vrahemi me ta*”, të cilët vazhduan dhe nuk u bënë zgjidhje. Tutje ka deklaruar se kanë biseduar me pronarin e firmës “B.”, nga i cili kanë kërkuar të bëhet kyçja e rrymës, i cili i ishte drejtuar me fjalët “*mos e prekni trafon, se ren ju la qaty*”, dhe i ka thënë “*se do të kyçemi se duhet të punojmë* “. Më tej kolegu i tij, B., e ka këputur drynin e trafos me shufër metalike, dhe në atë moment B. e ka nxjerr revolen dhe e ka repetu kolegut të tij, B.H. në gjoks duke i thënë “*do të vras*”, punëtorët e firmës së tyre dhe të firmës “B.”, i kanë ndarë dhe B. i është drejtuar me fjalët “*largohu se do të vras*”, revolen e mbante në dorë kah toka. Më tej ka shtuar se B. dhe një person tjetër tullac (qel) dhe baba i B.t kanë tentuar që të eskalojnë situatën duke sharë gjatë gjithë kësaj kohe. Pas dëgjimit të alarmit të policisë B. ka vrapsuar në drejtim të oborrit të shtëpisë dhe tani ka ardhur pa revole, por mbasi që Policia ka ardhur, dëshmitari i kishte treguar se B. e ka fshehur revolen diku në oborrin e firmës, e cila është gjetur nga zyrtarë policor.

#### *Provat e administruara:*

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, i datës 27.09.2017; Fotoalbumi, me gjithsejtë 13 faqe dhe 22 fotografi, Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit B.H. në polici, i datës 27.09.2017; Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit L.S. në polici, i datës 27.09.2017; Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit A.B. në polici, i datës 27.09.2017; Kërkesa e parashtruar nga firma “B.” SH.P.K., drejtuar KED për shkyçjen e MAB projekt dhe O.K.; Pëlqimi Elektroenergjetik me nr.599 e datës 26.08.2005 si dhe të dhënat për biznesin “B.”, Sh.p.k.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri ka dhënë mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor, duke theksuar se nuk ka përdorur armë, prej fillimit të

problemmit e derisa ka ardhur policia kishin qenë të gjithë në vendin e ngjarjes, pra ai (i pandehuri), babai i ndjerë dhe punëtorët e firmës. Në atë kohë ka qenë babai tashmë i ndjerë pronar i firmës “B.”, Sh.p.k, dhe arma ka qenë e imja të cilën e ka mbajtur për çështje sigurie, për të cilën edhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale armëmbajtje.

*Vlerësimi i Gjykatës për pikën I, vepra penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së:*

Sipas pikës I të aktakuzës, i pandehuri është akuzuar për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

I akuzuari B.F., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.09.2022, e ka pranuar në tërësi fajësinë për këtë pikë të aktakuzës.

Gjykata, pasi dëgjoi mendimin e palëve, ku edhe prokurori edhe mbrojtësi propozuan që të pranohet fajësia e deklaruar nga i akuzuari për këtë pikë, e shqyrtoi pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri, gjykata në këtë drejtim vlerësoi se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, i datës 27.09.2017; Fotoalbumi, me gjithsejtë 13 faqe dhe 22 fotografi, Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit B.H. në polici, i datës 27.09.2017; Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit L.S. në polici, i datës 27.09.2017; Procesverbali mbi marrjen në pyetje e dëshmitarit-ankuesit A.B. në polici, i datës 27.09.2017; Kërkesa e parashtruar nga firma “B.” SH.P.K., drejtuar Keds për shkyçjen e M. projekt dhe O.K.; Pëlqimi Elektroenergjetik me nr... e datës 26.08.2005 si dhe të dhënat për biznesin “B.”, Sh.p.k. Të gjitha këto prova janë bindëse për Gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimin e fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i’u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, por mund të ushtrojë ankesë vetëm sa i përket sanksionit penal, Gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, Gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet, pasi që ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar të gjitha elementet, qoftë objektive e po ashtu edhe ato subjektive, të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor.

*Vlerësimi i gjykatës për pikën II, vepra penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.*

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se i pandehuri B.F., me datë 27.09.2017, rreth orës 17:25 minuta, në rrugën e “Ulqinit” në Mitrovicë në afërsi të firmës “B.”, ka pasur një mosmarrëveshje me personin B.H., për shkak kyçjes së rrymës në rrjetin e firmës “O.K.”. Këto fakte nuk kanë qenë kontestuese në mes palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla gjykata i ka vërtetuar edhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve dhe provave tjera materiale.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse ishte pikërisht i pandehuri ai i cili në mënyrë kërcënuese ka përdorur armën ndaj të personit B.H. apo jo, e të cilën gjë i pandehuri në fjalën përfundimtare e ka mohuar.

I akuzuari në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor, e ka pranuar faktin se arma ka qenë e tij, të cilën e ka mbajtur për çështje sigurie, për të cilën veprën penale edhe e kishte pranuar fajësinë. Sipas tij ai nuk ka përdorur armë, prej fillimit të problemit e derisa ka ardhur policia.

Lidhur me këtë çështje, gjykata pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri, me datë 27.09.2017, rreth orës 17:25 minuta, në rrugën e “Ulqinit” në Mitrovicë në afërsi të firmës “B.”, për shkak të një mosmarrëveshje rreth kyçjes së rrymës nga punëtorët e firmës “O.K.”, i pandehuri armën e lartë cekur e kishte nxjerr nga brezi dhe ia kishte drejtuar në mënyrë kërcënuese të dëmtuarit B.H..

Këtë gjendje faktike, kjo Gjykatë e ka vërtetuar kryesisht duke u bazuar në deklaratimet e dy dëshmitarëve, dhe atë nga deklarimi i personit B.H., dhënë në Polici në cilësi të ankuesit, me datë 27.09.2017 dhe nga deklarimi i dëshmitarit L.S., dhënë gjithashtu në polici me datë 27.09.2017, e të mbështetura edhe nga dëshmia e dhënë në polici nga dëshmitari B.T., dëshminë e të cilit, gjykata e ka lexuar në shqyrtim kryesor për shkak se nuk është arritur të sigurohej prezenca e këtij dëshmitari për dëshmim të drejtpërdrejtë.

Vendimtare në vendosjen si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, përkatësisht shpallja fajtor e të pandehurit edhe për pikën II të dispozitivit, ishin deklaratat e dëshmitarëve B.H. dhe L.S., të dhëna në polici në fazën hetimore. Gjykata nuk ua ka falur besimin dëshmisë së këtyre dëshmitarëve të dhënë drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor për shkak se kanë qenë në esencë, në pjesët qenësore të tyre, në kontradiktë me deklaratimet që kishin dhënë menjëherë pas ngjarjes në polici dhe nëse vështrohen e analizohen me kujdes edhe në raport me provat tjera, del qartazi se deklaratimet e këtyre dy dëshmitarëve ishin me qëllim që të mos vërtetohej përgjegjësia penale e të pandehurit ndërsa arsyet për këtë, për gjykatën janë të panjohura. Në këtë kontekst, duhet



theksuar faktin se këta dy dëshmitar në fakt kanë konfirmuar ngjarjen sa i përket përdorimit të armës në mënyrë kërcënuese, por se kanë mohuar se ka qenë i pandehuri ai i cili kishte përdorur armën, duke aluduar se në fakt arma është përdorur nga babi i të pandehurit, M.F., i cili tashmë është i ndjerë.

Nga deklarimi i dëshmitarit B.H. dhënë në polici, gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kritike, rreth dy orë para se të ndodhte mosmarrëveshja, B., pra i pandehuri, kishte ndërprerë rrymën në trafo e cila trafo ishte e përbashkët për më shumë se dhjetë vite dhe se asnjëherë nuk kishin pasur probleme, dhe pasi që B. i kishte thënë L. se nuk e lëshon rrymën, kishin shkuar vet dëshmitari, së bashku edhe me N. dhe L. fillimisht në Kompaninë KEDS për të kërkuar nga ata që të lëshonin rrymën, dhe një ekip i KEDS-it kishin shkuar për të lëshuar rrymën në trafo mirëpo ka qenë babi i B. ai i cili nuk i ka lejuar ekipet e KEDS-it që ta lëshonin rrymën e ku më pastaj kishin dalur edhe vet B. me punëtor dhe nuk i kishin lejuar që ta lëshonin rrymën me ç ‘rast ekipi i KEDS-it ishte larguar. Tutje, nga dëshmia e këtij dëshmitari dhënë në polici, gjykata ka vërtetuar faktin se me tu larguar ekipet e KEDS-it, dëshmitari kishte tentuar që të hapte me çelës trafon mirëpo dikush kishte ndërruar drynin, në ato momente dëshmitari kishte marrë një armaturë e qëllim që ta hapte dryrin e trafos por në atë çast kishte ardhë i pandehuri B. dhe i ishte drejtuar me fjalët “*e lëshon rrymën, mo ski me hongër bukë*”, ku më pas kishte vrapuar te vetura e tij, kishte marrë armën duke i thënë pse e lëshove rrymën e ku dëshmitari i ishte përgjigjur se betoni është në betonjerkë dhe priset, ndërsa i pandehuri ia kishte afruar armën në krahun e majtë dhe e kishte goditur me tytën e armës ndërsa duke tenuar ta godas në kokë, e kishte goditur përsëri me “kondakt” të armës në krah, e kishte kapur për maice. Pas kësaj, pasi dëshmitari kishte parë armën, kishte ngritur duart lartë e ndërkohë kishin ndërhyrë disa punëtor të betonjerkës siç janë L., G., S. dhe të tjerë me ç ‘rast i pandehuri kishte futur fishekun në tytë dhe kishte thënë “largohuni t’ia dho një plum atij qeni se mo ska me hongër bukë”, e ku më pastaj B.T. ia ka ngritur dorën larë dhe e ka larguar të pandehurin nga aty. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, vërtetohet se vetura nga e cila i pandehuri e ka nxjerrë armën, ka qenë Xhip i bardhë i markës “T...”, në derën e të cilit shkruan “B.”, se armën të pandehurit ia ka larguar B.T. me punëtorët tjerë dhe se menjëherë pas ngjarjes, dëshmitari nuk ishte ndjerë i sigurt pasi që B. (i pandehuri) ia kishte drejtuar armën.

Nga analizimi i deklaratës së këtij dëshmitari dhënë në polici, rezulton qartë e padyshim që armën e kishte përdorur pikërisht i pandehuri, të cilin fakt, në këtë deklaratë e kishte konfirmuar në më shumë se një rast. Gjithashtu në këtë deklaratë, dëshmitari kishte konfirmuar se prezent në kohën kur kishin ardhë ekipet e KEDS-it për ta kyçur rrymën, kishte qenë edhe babai i të pandehurit dhe vet i pandehuri, të cilët nuk i kishin lejuar që të bënin ri kyçjen, pra nëse bëhet krahasimi i deklaratave nga shqyrtimi kryesor me atë që ka dhënë dëshmitari në polici, theksimet e dëshmitarit se nuk i ka njohur personat, se personi që i ka drejtuar armën ka qenë i moshuar, mbi 50 vjeç dhe se nuk ka qenë i pandehuri ai që ka drejtuar armën, për gjykatën janë plotësisht të pabesueshme dhe të pabazuara, në kundërshtim me provat tjera qoftë personale e po ashtu edhe ato materiale, prandaj edhe ka vendosur që t’ia falë besimin deklaratës së dhënë në polici pasi që e njëjta është bindëse, është dhënë menjëherë pas ngjarjes, dëshmitari ka përshkruar në mënyrë të detajuar se si ka ndodhur ngjarja dhe për më tepër, është në harmoni edhe me deklarinin e dëshmitarëve tjerë siç janë dëshmitarët L.S. dhe B.T..

Nga deklarata e dëshmitarit L.S. dhënë në polici me datë 27.09.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kritike, në vendin e punës së dëshmitarit “M.. SH.P.K”, afër “B.T”, në Shupkocv të Mitrovicës, pronari i betonjerkës “B.”, kishte çkyqur rrymën në trafo për linjën e cila furnizonte edhe fabrikën ku punonte ky dëshmitar. Gjithashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se paraprakisht, dëshmitari, bashkë edhe me persona tjerë, kishin shkuar fillimisht në Kompaninë KEDS me kërkesën për tu ri kyçur në rrjetin elektrik, paçka se një ekip i KEDS-it kishin shkuar për të bërë ri kyçjen në rrjet mirëpo që ishin penguar nga B... “L..” dhe nga babi i tij, M. duke iu drejtuar ekipit të KEDS-it me fjalët se “asnjë i gjallë nuk do të dalë nëse e prekë dikush trafon” dhe njëkohësisht duke mbajtur dorën në brez, çka kishte ndikuar që në këtë situatë, punëtorët e KEDS-it të largoheshin.

Gjithashtu, nga deklarimi i këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se pasi që punëtorët e ndërmarrjes KEDS ishin penguar për ta bërë ri kyçjen në rrjetin elektrik, kolegu i këtij dëshmitari, B.H., pasi që paraprakisht kishte kërkuar nga i pandehuri që t’ua mundësonte që të ri kyçen përmes trafos në rrymë, dhe pasi që i pandehuri nuk kishte lejuar, B.H. kishte dashur që ta thente drynin dhe të bënte kyçjen në rrjetin elektrik, me ç ‘rast kishte ndërhyrë i pandehuri duke nxjerrë armën, duke e repetuar të njëjtën dhe duke ia drejtuar këtu dëshmitarit B.H., mirëpo kishin ndërhyrë punëtorët e të dyja firmave dhe për fat të mirë nuk ka shkreput ndonjë plumb.

Gjykata, pas analizimit të kujdesshëm të deklaratës së dhënë nga ky dëshmitar në polici, ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë se ishte pikërisht i pandehuri B.F., ai i cili kishte përdorur armën në mënyrë kërcënuese në raport me ankuesin – këtu dëshmitarin B.H.. Edhe ky dëshmitar, sikurse ai paraprak, kishte konfirmuar se në ditën kritike, në kohën kur kishte qenë prezent ekipi i KEDS-it për ta ri kyçur energjinë elektrike, aty kishte qenë përveç të pandehurit, edhe babi i tij, M. (tashmë i ndjerë). Në këtë kontekst, nëse krahasohen deklarata e dëshmitarit, ajo të cilën e ka dhënë në polici në kohën kur ka ndodhur ngjarja, me atë të dhënë në Gjykatë, na rezulton një dallim i madh në aspektin e identifikimit të personit i cili kishte përdorur armën. Kjo për shkak se në polici, dëshmitari qartë dhe pa mëdyshje kishte përmendur të pandehurin B., si personi që kishte poseduar dhe përdorur armën në mënyrë kërcënuese në raport me personin – këtu dëshmitarin B.H., dhe këtë e kishte konfirmuar, brenda deklaratës, në së paku dy raste, kishte bërë dallimin e qartë të personave pjesëmarrës, përkatësisht të pandehurit dhe babit të tij, nuk kishte pasur asnjë hamendje se a ishte “person i moshuar me flok të bardha”, nuk kishte shfaqur asnjë dilemë se kush ishin personat përkatësisht pronarët e firmës “B.” dhe vet i pandehuri, dhe shpërfaqja e këtyre dilemave dhe paqartësive në shqyrtim gjyqësor, e ka bërë deklarin e dhënë nga ky dëshmitar në shqyrtimin kryesor, si tërësisht të pa besueshëm e çka ka ndikuar që t’i falet besimi deklaratës së dhënë në polici menjëherë pas ngjarjes.

Kjo pasi që një dëshmi e tillë, është dhënë menjëherë pas ngjarjes, për më tepër gjen mbështetje edhe në provat tjera personale, është bindëse pasi që ka përshkruar në mënyrë të detajuar se si ka ndodhur ngjarja dhe për më tepër, është në përputhje edhe me provat materiale, përkatësisht me vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të datës 27.09.2017, në emër të pandehurit B.F., të cilit i ishte sekuestruar një armë Pietro Berta Gardone, prodhim italian, calibri 7.65 mm, me nr. serik ..., një karikator dhe 5 fishekë, si dhe nga fotot e paraqitura pasqyrohen në disa fotografi arma dhe karikator si dhe disa fishek të sekuestruar.

Deklarimet e këtyre dy dëshmitarëve, mbështeten në tërësi edhe nga deklaratat e dhënë nga dëshmitari B.T. në polici, me datë 27.09.2017, i cili pothuajse në mënyrë identike sikurse dëshmitarët B.H. dhe L.S., kishin përshkruar ngjarjen, e të cilën deklaratë, gjykata vetëm e kishte lexuar në shqyrtim kryesor për shkak se nga verifikimet e bëra, kishte rezultuar se ky dëshmitar jeton jashtë vendit dhe se adresë të saktë të tij, nuk kishte. Duke pasur parasysh kufizimet e përcaktuara në nenin 257 paragrafi 1 të KPP-së, dëshmia e këtij dëshmitari nuk ishte vendimtare në vendosjen e kësaj çështjeje.

Nga deklarimi i dëshmitarit A.B., gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kritike, kishte pasur fjalosje ndërmjet punëtorëve të firmës së tij dhe të firmës “B.”. Deklarimit të këtij dëshmitari se sa i përket faktit se B. (i pandehuri) ka pasur armë, ka qenë vetëm një ngatërrim i punëtorëve të tij, nuk ia ka falur besimin pasi që përveç se ky dëshmitar, siç kishte konfirmuar edhe vet, nuk ishte dëshmitar okular, kjo është në kundërshtim edhe me provat personale dhe materiale të administruara e të shtjelluara më lart.

Gjykata si përfundim gjen i pandehuri ditën kritike, e ka poseduar armën e llojit “Pietro Berta Gardone”, dhe në mënyrë kërcënuese gjatë fjalosjes me personin B.H., nga brezi e ka nxjerr dhe përdorur armën dhe i është drejtuar B.H.t me fjalët *”e lëshon rrymën, mo ski me hongër bukë”*, çka te i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë personale.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndaj të pandehurit B.F. duke e shpallur të njëjtin fajtor, pasi që në bazë të provave të administruara, u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se në veprimet e këtij të akuzuari, janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.

Neni 375 paragrafi 2 i KPRK-së, përcakton se: *“2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.”*

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri B.F., kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale, ashtu që ditën kritike, me datë 27.09.2017, rreth orës 17:25 minuta, në afërsi të Firmës “B.” në Mitrovicë, kishte përdorur armën Pietro Bereta Gardone në mënyrë kërcënuese ndaj personit B.H., dhe kjo kishte ndodhur pasi që paraprakisht i pandehuri kishte çkyqur energjinë elektrike të firmës “O.K.”, në të cilën Firmë punonte edhe B.H., dhe pasi që ky i fundit kishte tentuar që të ri kyçte energjinë elektrike, i pandehuri kishte nxjerrë armën dhe duke ia afruar në gjoks, i ishte drejtuar me fjalët *“askush nuk guxon ta kyçë rrymën”*, e me të cilat fjalë dhe veprime, te personi B.H., ishte shkaktuar ndjenja e frikës dhe pasigurisë personale.

Gjykata rikujton se veprimet e të pandehurit, të përshkruara si më lart, kanë qenë qartazi të kundërligjshme, pasi që nuk lejohet përdorimi i armës me qëllim frikësimi a kërcënimi ndaj integritetit trupor të personave tjerë, andaj përmes këtyre veprimeve, të tilla siç janë kërcënimi i përdorimit të armës, ka rrezikuar atë që është më e çmueshmja e njeriut, e që është integriteti trupor dhe siguria personale, e që sipas nenit 375 paragrafi 2 të KPRK-së, specifikisht mbrohet integriteti dhe jeta e personit nga rreziku qoftë edhe nëse ai rrezik është vetëm abstrakt.

Përveç elementeve të përgjithshme, gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit, janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari e kishte përdorur armën me qëllim frikësimi të personit tjetër dhe krejt kjo me qëllim që B.H., të mos e kyçte rrymën për firmën për të cilën i njëjti punonte. Gjithashtu, i pandehuri me veprimet e tij, kishte rrezikuar jetën dhe integritetin e personit B.H. duke drejtuar armën, në mënyrë kërcënuese, në drejtim të trupit të këtij personi, andaj të gjitha këto, tregojnë se janë konsumuar elementet, si të përgjithshme, po ashtu edhe ato të veçanta të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 i KPRK-së.

*Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së.

Rrethana rëndësuese në këtë çështje penale, gjykata mori parasysh dashjen e lartë të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale.

Ndërsa si rrethana lehtësuese, Gjukata e ka vlerësuar faktin se i akuzuari në tërësi e ka pranuar fajësinë për pikën I të akuzës, pastaj faktin se kjo është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ngase nuk ka prova që e vërtetojnë të kundërtën, rrethanë tjetër lehtësuese është vlerësuar edhe sjellja përgjithësisht korrekte të pandehurit, rrethanat familjare të të njëjtit pasi që është person familjar dhe baba i tre fëmijëve dhe gjithashtu edhe kohën e kaluar nga kryerja e këtyre veprave penale duke qenë se tashmë kanë kaluar afërsisht shtatë vite nga koha kur janë kryer këto vepra penale.

Marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të lart cekura, gjykata, sa i përket veprës penale si në pikën II të dispozitivit, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit dhe kjo në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethana posaçërisht lehtësuese faktin që për të pandehurin nuk ka asnjë dëshmi se ka qenë me parë i dënuar si dhe kohën e kaluar nga kryerja e veprave penale, andaj edhe ka zbutur dënimin nën minimumin e paraparë për këtë veprë penale, në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me burgim të kushtëzuar ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjukata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

*Vendimi për konfiskimin e armëve:*

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit, ka urdhëruar konfiskimin e sendit, respektivisht një (1) armë Pietro Berta Gardone, prodhim italian, ne nr. serik, kalibrit 7.65 mm, dhe një (1) karikator me pesë (5) fishekë, duke marrë për bazë sigurinë publike, po ashtu të njëjtat janë sende që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit, në mbështetje të nenit 276 paragrafi 1 e lidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.1 të KPP-së, ku përcakton se armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 364 deri me 369 të Kodit Penal, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit

*Shpenzimet e procedurës:*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, në aktakuzë nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni, 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.124/2023, datë 29.03.2024**

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.